

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7015  
E shtunë, 7 tetor 2023  
Çmimi 0.50 €

## Strategjia e Serbisë kundër Perëndimit përmes Kosovës

FAQE 8-9

HAJDIN  
ABAZI



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE



**SAMITI I MINISTRAVE TË JASHTËM NË TIRANË, BAERBOCK: KONFLIKTI NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË, KËRCËNIM PËR PROCESIN E BERLINIT** F. 5

**KOSOVA E HUMBET ARBITRAZHIN ME "CONTOUR GLOBAL"** F. 6

**BISLIMI: KOSOVA PO DËSHMON ANGAZHIMIN PËR AVANCIMIN E AGJENDËS EVROPIANE** F. 6

### EKONOMI



**BANKA BOTËRORE NGRE PARASHIKIMIN PËR 0.8 % PËR RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË** F. 7

**GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË VIZITOI BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS** F. 7

### SPORT



**KOSOVA ME RISI PËR NDESHJET E TETORIT, MUNGON RRAHMANI** F. 10

E PAPEREDENTË: KRYEMINISTRI KURTI DHE MINISTRAT E TIJ REFUZOJNË TË PËRGGJIGJEN NË PYETJET PARLAMENTARE TË DEPUTETËVE TË OPOZITËS PËR SHKAK TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

## KURTI DHE MINISTRAT REFUZOJNË T'I PËRGGJIGJEN OPOZITËS NË PYETJET PARLAMENTARE



**- Opozita: Veprimi i Kurtit, shantazh ndaj deputetëve dhe në kundërshtim me Kushtetutën**

Për herë të parë në historinë parlamentare të Kosovës një kryeministër refuzon të përgjigjet në pyetjet parlamentare të deputetëve të opozitës. Një gjë të tillë e ka bërë të premtën kryeministri Albin Kurti dhe ministrat e tij.

Kurti ka thënë se nuk do të përgjigjet në pyetjet parlamentare të deputetëve për shkak të mosvotimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Njëjtë si Kurti kanë vepruar edhe ministrat e tij, duke u përgjigjur vetëm në pyetjet e

deputetëve LV-së. Veprimi i tillë i Kurtit dhe ministrave të tij është kritikuar nga opozita. Përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se Kurti po tenton t'i shantazhojë deputetët dhe është duke vepruar në kundërshtim me Kushtetutën

## KOMANDANTI I KFOR-it PARALAJMËRON PËRFORCIME SHITESË NË KOSOVË

FAQE 3



Komandanti në shkuarje i KFOR-it, Angelo Michele Ristuccia, ka thënë se situata në Kosovë është më e qetë sesa ditët e fundit, mirëpo "nëse palët nuk ulen për ta negociuar një zgjidhje politike, kjo situatë do të jetë më e cenushme dhe më e

paqëndrueshme sesa ajo paraprake". "Të dyja palët duhet të ulen në tavolinë negociuese. Prandaj e mbështetim dialogun. Besojmë plotësisht në përpjekjet diplomatike për ta gjetur një zgjidhje për këtë situatë", ka pohuar Ristuccia

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Suedia nis ndihmë shtesë ushtarake në Ukrainë

STOKHOLM, 6 TETOR - Suedia do të dërgojë në Ukrainë ndihmë të re ushtarake, në vlerë të 199 milionë dollarëve, ka thënë ministri suedez i Mbrojtjes, Pal Jonson. Ai ka njoftuar se pjesa më e madhe e ndihmës përbëhet prej municionit. Jonson ka thënë në një konferencë për media se qeveria u ka kërkuar zyrtarisht forcave të armatosura që të vlerësojnë nëse Suedia do të mund t'i dërgojë aeroplanët luftarakë JAS Gripen në Ukrainë. Më vonë, Jonson e ka përmendur që për çështje të brendshme të sigurisë, Suedia fillimisht duhet të bëhet vend anëtare e NATO-s para se të mund të shpërndajë pajisje të tilla. Suedia shpreson që do të

mund t'i bashkohet aleancës veri-atlantike këtë vjeshtë dhe të marrin fund procedurat e ratifikimit nga ana e Turqisë dhe Hungarisë. Ndihma e re ushtarake do të jetë e 14-ta që Suedia nis në Ukrainë, prej nisjes së luftës në shkurt të vitit 2022. Liderët evropianë janë mbledhur në Granada të Spanjës për të diskutuar rreth përkushtimit për t'i ndihmuar Ukrainës, pas turbulencave të fundit politike në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat i kanë rritur dilemat në këtë drejtim. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka paralajmëruar të enjten se Rusia mund t'i sulmojë edhe shtetet e tjera brenda pesë vjetëve nëse Evropa zbeh mbështetjen.



Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë

e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Danimarkë, ligji për t'i tjetërsuar lagjet me migrantë konsiderohet racist



KOPENHAGË, 6 TETOR - Banorët e zemëruar të një lagjeje në Kopenhagë kanë thënë se do t'i rezistojnë ligjit danez që u mundëson autoriteteve t'i dëbojnë banorët nga zonat ku ato vlerësojnë se ka shumë migrantë. "Ky është racizëm", ka thënë Jawad, mjek prej lagjes Mjølnerparken në qendër të Kopenhagës, e cila është e rrethuar me zona të tjera që janë duke u tjetërsuar. "Ndonëse kam lindur dhe jam rritur në Danimarkë, në statistika unë jam migrant

joperëndimor", ka thënë ky 29-vjeçar për agjencinë e lajmeve AFP. Danimarka e ka miratuar një ligj kontrovers më 2018 për t'i rihvilluar disa "geto" të varfra, në të cilat ka koncentrim të madh të migrantëve. Në plane përfshihet rindërtimi dhe renovimi i pronave dhe ndryshimi i mënyrës së qiradhënies. Për disa dekada Danimarka ka qenë një prej vendeve me politikën më strikte për

migrantët në Evropë dhe, me raste, partitë e ekstremit të djathtë kanë folur edhe me tone kundër migrantëve. Tetë në 10 persona në Mjølnerparken konsiderohen "joperëndimorë", dhe personat nga vendet jashtë BE-së prej Ballkanit dhe Evropës Lindore hyjnë në atë kategori. Banorët e lagjes Mjølnerparken kanë thënë se do ta paditin Danimarkën në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

## Rusia shqyrton revokimin e ratifikimit të traktatit që ndalon testimet bërthamore

MOSKË, 6 TETOR - Kryetari i Parlamentit rus, Vyacheslav Volodin, ka thënë të premten se ligjvënësit rusë do ta konsiderojnë revokimin e ratifikimit të Traktatit për Ndalim të Testimeve Bërthamore, pasi presidenti rus Vladimir Putin e ka përmendur mundësinë e rikthimit të testimeve të këtilla. Veprime kësajsoj nga ana e Rusisë, apo e Shteteve të Bashkuara, do të mund të jenë destabilizuese në kohën e rritjes së tensioneve mes dy vendeve. Putini ka thënë të enjten se doktrina bërthamore e Rusisë nuk ka nevojë për përditësim dhe se nuk është gati të deklarohet nëse Rusia duhet t'i rikthejë testimet

bërthamore. Shefi i Kremlinit ka thënë se Rusia do ta shqyrtojë mundësinë e revokimit të traktit, të cilin Shtetet e Bashkuara e kanë nënshkruar, por nuk e kanë ratifikuar. "Situata në botë është duke ndryshuar", ka thënë Volodin, duke shtuar: "Uashingtoni dhe Brukseli kanë nisur luftë kundër shtetit tonë". Deklaratat e Putinit dhe Volodinit sugjerojnë se Rusia edhe mund ta revokojë ratifikimin e traktatit, i cili e ndalon shpërthimin e armëve bërthamore nga çdokush. Rusia ka më së shumti koka bërthamore në botë, shumicën të trashëguara nga



Bashkimi Sovjetik. Sipas Kombeve të Bashkuara, përgjatë pesë dekadave, prej vitit 1945 deri më 1996, janë kryer më shumë se 2 000

testime bërthamore - 1 032 nga ShBA-ja dhe 715 nga Bashkimi Sovjetik. Bashkimi Sovjetik e ka testuar për herë të fundit një

armë bërthamore më 1990, ndërsa ShBA-ja më 1992. Më vonë testime bërthamore kanë kryer edhe India, Pakistani dhe Koreja Veriore.



KOMANDANTI NË SHKUARJE I KFOR-IT, ANGELO MICHELE RISTUCCIA, KA MBAJTUR KONFERENCË LAMTUMIRËSE PËR MEDIET NË PRISHTINË

# Komandanti i KFOR-it paralajmëron përforcime shtesë në Kosovë



Komandanti në shkuarje i KFOR-it, Angelo Michele Ristuccia, ka thënë se situata në Kosovë është më e qetë sesa ditët e fundit, mirëpo “nëse palët nuk ulen për ta negociuar një zgjidhje politike, kjo situatë do të jetë më e cenueshme dhe më e paqëndrueshme sesa ajo paraprake”. “Të dyja palët duhet të ulen në tavolinë negociuese. Prandaj e mbështetim dialogun. Besojmë plotësisht në përpjekjet diplomatike për ta gjetur një zgjidhje për këtë situatë”, ka pohuar Ristuccia

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 TETOR - Komandanti i misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, Angelo Michele Ristuccia, ka thënë të premten se së shpejti në Kosovë do të arrijnë trupa shtesë nga Rumania, përveç përforcimeve të fundit të Britanisë së Madhe. Ai ka paralajmëruar përforcime edhe nga “vendet e tjera aleate”. Në një konferencë lamtumirës për mediet në Prishtinë, teksa e kryen mandatin e tij, Ristuccia ka thënë se rritja e numrit të trupave në Kosovë është e domosdoshme në mënyrë që KFOR-i të mund ta përmbushë mandatin që ka. Ristuccia i ka përmendur incidentet e muajve të fundit,

kryesisht në veri të Kosovës, dhe ka vlerësuar se të gjitha tregojnë që situata mbetet e paqëndrueshme dhe mund të tensionohet shpejt. Ai ka përmendur që vetëm një zgjidhje politike do të mund të garantojë paqe të qëndrueshme në rajonin e Ballkanit, dhe e ka përsëritur mbështetjen e KFOR-it për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve. Situata është përshkallëzuar pas sulmeve ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator. Si pasojë e sulmeve është vrarë rreshteri policor Afrim Bunjaku. Në shkëmbim e sipër të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues serbë. Kosova e ka fajësuar Serbinë për

sulmin, mirëpo kjo e fundit e ka hedhur poshtë këtë pretendim. Komandanti në shkuarje i KFOR-it ka thënë se situata tani në Kosovë është më e qetë sesa ditët e fundit, mirëpo “nëse palët nuk ulen për ta negociuar një zgjidhje politike, kjo situatë do të jetë më e cenueshme dhe më e paqëndrueshme sesa ajo paraprake”. “Dy palët duhet të ulen në tavolinë negociuese. Prandaj e mbështetim dialogun. Besojmë plotësisht në përpjekjet diplomatike për ta gjetur një zgjidhje për këtë situatë”, ka pohuar Ristuccia. I pyetur për mundësinë e ndërtimit të bazës së re ushtarake në Kosovë, Ristuccia ka thënë se nuk sheh nevojë për diçka të tillë. Ai ka rikujtuar se KFOR-i është

## Gjermania vitin e ardhshëm do t'i dërgojë 150 ushtarë në Kosovë

Gjermania do t'i dërgojë rreth 150 ushtarë në Kosovë, në prill të vitit të ardhshëm, ka thënë një zëdhënës i Ministrisë gjermane të Mbrojtjes të premten. Ditë më parë gazeta gjermane “Spiegel” pati raportuar se autoritetet gjermane janë duke e shqyrtuar marrjen e një vendimi të tillë për ta përforcuar misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR. KFOR-i ka aktualisht rreth 4 500 trupa në Kosovë nga 27 shtete të NATO-s dhe shtetet partnere.

përgjegjës për ruajtjen e zonës kufitare të Kosovës me Serbinë dhe ka forca të angazhuara përreth saj, mirëpo që terreni problematik, kryesisht malor, lë hapësirë për qarkullime të shumëfishta. I pyetur se si ka arritur të hyjë në Kosovë gjithë sasia e armatimit që është konfiskuar nga Policia e Kosovës, komandanti i KFOR-it ka thënë se ende janë duke u bërë hetime, mirëpo marrë parasysh sasinë dhe llojin, dihet që qëllimi i sulmit ka qenë destabilizimi. “Situata pas dorëheqjes së serbëve nga institucionet e Kosovës, përfshirë rreth 570

zyrtarë policorë, e ka krijuar një vakum shumë të rrezikshëm në veri. Kjo pasiguri përbën shqetësim për ne. Prandaj bëjmë thirrje për ulje të menjëhershme në tavolinën e negociimit”, ka thënë Ristuccia, duke e vënë theksin te nevoja e riintegritetit të serbëve në institucionet e Kosovës. Serbët në Kosovë kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar në shenjë pakënaqësie ndaj një vendimi të Qeverisë së Kosovës për reregjistrim të makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

## Kurti takohet me Szunyog, flasin për hetimet rreth sulmit terrorist të 24 shtatorit

PRISHTINË, 6 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar të premten shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, njëherësh përfaqësues special i BE-së, Tomas Szunyog. Sulmi terrorist, paramilitar dhe kriminal i 24 shtatorit ndaj Policisë së Kosovës, hetimet që po zhvillohen rreth synimeve dhe autorëve të këtij sulmi,

procesi i Berlinit në prag të samitit të radhës dhe përgatitjet e Raportit të Vendit, ishin temat kyçe të bisedës në takimin e sotëm. Ambasadori Szunyog i shprehu edhe një herë ngushëllime kryeministrit, familjes Bunjaku dhe popullit të Kosovës për heroën e Kosovës, Afrim Bunjaku, rreshterin e policisë i cili ra në detyrë në mbrojtje të

rendit, ligjshmërisë, kushtetutshmërisë, sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial. Ambasadori më tej e njoftoi kryeministrin Kurti për përgatitjet që Komisioni Evropian është duke i bërë në finalizimin e Raportit të Vendit për vitin 2023, i cili pritet të miratohet në pjesën e parë të muajit nëntor.







**E PAPRECEDENTË: KRYEMINISTRI KURTI DHE MINISTRAT E TIJ REFUZOJNË TË PËRGJIGJEN NË PYETJET PARLAMENTARE TË DEPUTETËVE TË OPOZITËS PËR SHKAK TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

# Kurti dhe ministrat refuzojnë t'i përgjigjen opozitës në pyetjet parlamentare

**- Opozita: Veprimi i Kurtit, shantazh ndaj deputetëve dhe në kundërshtim me Kushtetutën**

Për herë të parë në historinë parlamentare të Kosovës një kryeministër refuzon të përgjigjet në pyetjet parlamentare të deputetëve të opozitës. Një gjë të tillë e ka bërë të premten kryeministri Albin Kurti dhe ministrat e tij. Kurti ka thënë se nuk do të përgjigjet në pyetjet parlamentare të deputetëve për shkak të mosvotimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Njëjtë si Kurti kanë vepruar edhe ministrat e tij, duke u përgjigjur vetëm në pyetjet e deputetëve LV-së. Veprimi i tillë i Kurtit dhe ministrave të tij është kritikuar nga opozita. Përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se Kurti po tenton t'i shantazhojë deputetët dhe është duke vepruar në kundërshtim me Kushtetutën

pyetjet parlamentare të deputetëve të opozitës përderisa ata nuk janë duke i votuar marrëveshjet ndërkombëtare. "Për shkak se nuk po i votoni marrëveshjet ndërkombëtare, të gjithë deputetët që i bëjnë pyetjet nuk do ta kenë përgjigjen time edhe pse tashmë e kam të përgatitur. Duhet të jemi kolegë të të njëjtit shtet, e jemi të njëjtit shtet nëse bëhet fjalë për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesit publik dhe shtetëror. Nuk ka pasur kryeministër në Kosovën e pavarur që është përgjigjur më shpesh dhe më me përpikëri pyetjeve parlamentare. Nga 377 marrëveshje ndërkombëtare që

unë kur isha opozitë kanë kaluar këtu, vetëm tri prej tyre nuk janë votuar. 374 janë votuar. Rrjedhimisht, atëherë kur jeni deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, vetëm atëherë unë do të përgjigjem në pyetjen parlamentare sepse sigurohem që bëhet fjalë për Kuvendin e Kosovës", ka thënë Kurti, duke iu referuar deputetes së AAK-së, Time Kadrijaj, e cila kishte një pyetje parlamentare. Më tutje, Kurti u ka thënë deputetëve të opozitës se nuk mund t'i drejtojnë pyetje atij derisa, sipas tij, janë duke e dëmtuar shtetin. "Nuk mund t'i bësh pyetje parlamentare

**EPOKA  
ERE**

**Lirim GECI**

PRISHTINË, 6 TETOR - Qëkur funksionon jeta parlamentare në Kosovës nuk ka ndodhur që një

kryeministër të deklarohet publikisht se nuk përgjigjet në pyetjet parlamentare të deputetëve të Kuvendit, por një gjë të tillë e ka bërë të premten kryeministri Albin Kurti dhe

ministrat e tij, të cilët janë përgjigjur vetëm në pyetjet e deputetëve nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje. Kurti në fjalën e tij në Kuvend ka thënë se nuk do të përgjigjet në



# Samiti i ministrave të Jashtëm në Tiranë, Baerbock: Konflikti në mes të Kosovës dhe Serbisë, kërcënim për Procesin e Berlinit

**TIRANË, 6 TETOR** - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani, ka mirëpritur ministrat e Jashtëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor, vendeve të BE-së në Procesin e Berlinit, përfaqësuesit e institucioneve të BE-së, si dhe përfaqësuesit e organizatave rajonale. Hasani ka pritur krerët e delegacioneve në hyrjen e Pallatit të Brigadave ku është

mbajtur edhe Ministeriali.

Ndër të parët që mbërriti ishte homologu grek George Gerapetritis, ministri i Punëve të Jashtëm i Greqisë. Po ashtu, Hasani mirëpriti Oliver Varhelyi, komisionarin e BE-së për Fqinjësinë dhe Zgjerimin. Varhelyi ka deklaruar se anëtarësimi i Shqipërisë në BE po ndodh. "Që nga 1 janari i vitit të ardhshëm BE është gati për t'i pritur shtetet e reja të Ballkanit

Perëndimor", tha ai.

E pranishme ishte edhe ministrja e Jashtëm e Gjermanisë, Annalena Baerbock, e cila në një prononcim për medie para hyrjes në Pallatin e Brigadave, ka theksuar se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë vënë në rrezik procesin e Berlinit. "Ne jemi këtu në mes të Evropës dhe kjo është rruga për të shkuar më shpejt drejt BE-së. E rëndësishme për ndërlidhjen

mes Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Marrëveshje për ndërveprimin mes vendeve, siguri, mbrojtje dhe lëvizshmëri. Konflikti në mes të Kosovës dhe Serbisë është potencial kërcënim për Procesin e Berlinit. Jemi në të njëjtën linjë me ShBA-në dhe BE-në sa i përket tërheqjes së forcave serbe nga veriu i Kosovës. Duhet të tregojmë vendosmëri më të madhe me

praninë e KFOR-it në komunat me shumica serbe", ka thënë Baerbock.

Ministri Hasani mirëpriti edhe ministrin e Jashtëm të Kosovës, Donika Gërvalla; ministrin e Jashtëm të Serbisë, Ivica Daçiç, kryeministrin e Malit të Zi, Dritan Abazoviç, njëkohësisht ministër në detyrë për punët e jashtëm.

Ky takim është zhvilluar me dyer të mbyllura.



kryeministrit dhe ta dëmtosh shtetin në masën e përgjithshme, 360 milionë nga ajo duzinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat ju refuzoni t'i votoni. Shumica e thjeshtë – mazhoranca, qeveria bëhet me 61 (vota). Kushtetuta thotë që pikërisht republika jonë mos të jetë republikë ku një qeveri ka edhe mbi 2/3 do të duhej që edhe deputetët, gjithnjë të Kuvendit, gjithnjë të të njëjtit shtet të jenë aty për marrëveshjet ndërkombëtare dhe interesin e përgjithshëm. Prandaj, me keqardhje unë nuk mund të përgjigjem në pyetjet parlamentare që nuk vijnë nga ky Kuvend", ka thënë Kurti

Ky veprim i Kurtit nuk i ka pëlqyer aspak deputetes Time Kadrijaj. Ajo i ka thënë Kurtit se është duke punuar vetëm për ta shkatërruar shtetin e Kosovës. "Mos u përgjigj se ti je këtu për ta shkatërruar shtetin e Kosovës. Ti nuk i ke lejuar deputetët e tu të votojnë për

Policinë e Kosovës, për përkrahje me mjete financiare për policinë, e cila po e mbron sovranitetin dhe integritetin e Kosovës. Shko shëtitu nëpër Greqi sa të duash se hair si ke bërë këtë shtet as nuk ke për t'i bërë", ka thënë Kadrijaj. Refuzimi i Kurtit për t'u përgjigjur në pyetjet parlamentare ka bërë që deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ta lëshojnë sallën e Kuvendit.

## Opozita: Veprimi i Kurtit, shantazh ndaj deputetëve dhe në kundërshtim me Kushtetutën

Pas largimit nga salla e Kuvendit e Kosovës kanë pasuar reagimet e deputetëve të opozitës në lidhje me veprimin e kryeministrit Albin Kurti dhe ministrave të tij.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK),

Abelard Tahiri, në një konferencë për medie ka thënë se veprimi i kryeministrit Kurti në Kuvend është sulm direkt ndaj demokracisë parlamentare në Kosovë pasi, sipas tij, mandati i deputetit është i garantuar dhe askush nuk mund t'ua përcaktojë rregullat në vendin e tyre të punës. "Pyetja parlamentare është një nga instrumentet e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili e shfrytëzon për llogaridhënie nga qeveria, nga kryeministri, ministrat, zëvendësministrat e kështu me radhë. Sjellja e kryeministrit të Republikës së Kosovës ishte një sulm direkt ndaj demokracisë parlamentare në vendin tonë. Nuk ka ndodhur asnjëherë, është e paprecedentë. Nuk e keni asnjë rast të vetëm kur kryeministri del dhe u thotë deputetëve që unë kam vendosur mos t'ju përgjigjem deri në momentin kur ju do ta bëni një veprim tjetër", ka thënë ai.

Më tutje, Tahiri e ka ftuar kryetarin e

Kuvendit të marrë masa ndaj këtyre veprimeve dhe njerëzve të papërgjegjshëm nga kryeministri e tutje. "Në anën tjetër ju e shihni se dështimet në këtë vend janë të mëdha, janë kolosale. Ju e shihni skamjen, mjerimin dhe krizën ekonomike që e ka kapluar vendin. Problemi më i madh është se e kemi një kryeministër të padijshëm dhe të papërgjegjshëm", ka thënë Tahiri.

Ndërsa shefi i deputetëve i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se kundërshtimi i kryeministrit Albin Kurti që të përgjigjet ndaj pyetjeve të opozitës është shkelje e Kushtetutës dhe shantazh. "Për herë të parë në parlamentarizmin e Kosovës refuzon t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve të opozitës. Kjo është shkelje e rëndë e Kushtetutës dhe shantazh. Ky tentim për detyrim ndaj deputetëve është i papranueshëm. Po hyjmë në një sistem të paparë", ka thënë Gashi.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se veprimi i Kurtit është ogur i keq për demokracinë e Kosovës. "Është nivel i ri i demokracisë dhe me sjelljen e arrogancës së kryeministrit ne e lëshuam seancën", ka thënë Gashi, duke shtuar se qeveria duhet t'i bëjë numrat për t'i votuar marrëveshjet ndërkombëtare apo ta zgjerojë koalicionin qeverisës.

Gashi ka folur edhe për deklaratat e Albin Kurtit se nëse "shkojmë në zgjedhje, zhduket opozita". "Ani more le të zhduket. Nëse është vullnet i popullit që të zhduket opozita, atëherë vazhdojmë. Nuk është problem se Albin Kurti ka për synim t'i zhdukë kundërshtarët. Sot i ka bërë katër vjet qeverisje dhe cili është rezultati i këtij pushteti?", ka thënë Gashi.

Ndaj veprimit të Kurtit kanë reaguar edhe deputetët e tjerë të opozitës, duke thënë se kryeministri është duke ikur nga përgjegjësitë që ka.



## Alban Zogaj zgjedhet kryetar i Degës së Tretë të LDK-së në Prishtinë

PRISHTINË, 6 TETOR - Të enjten në mbrëmje është mbajtur Kuvendi i Dhjetë Zgjedhor i Degës III të LDK-së në Prishtinë, e cila njihet si "Dega e presidentit Rugova".

Njëqind e një delegatët e këtij Kuvendi zgjodhën dr. Alban Zogaj kryetar me mandat katërvjeçar.

"Kryetarin e deritanishëm z. Hazir Borovci e falënderova për udhëheqjen tetëvjeçare të degës. Kalimi i përgjegjësive tek ekipi i ri bëhet pas përmbylljes me plot sukses të udhëheqjes e fitores në kryeqytet", ka bërë me dije kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Abdixhiku ka thënë se zgjedhjet në LDK janë festë. "Po i afrohemi ngadalë fundit të procesit zgjedhor, me rreth 35 mijë pjesëmarrës. Si rrallëherë më parë, ky proces, përveçse manifestim i demokracisë, u shndërrua edhe në mobilizim të anëtarësisë e qytetarisë aktive", ka thënë Abdixhiku.



## Kosova e humbet arbitrazhin me "Contour Global"

PRISHTINË, 6 TETOR - Qeveria e Kosovës e ka humbur arbitrazhin ndërkombëtar me kompaninë amerikane "Contour Global" për mosrespektim të kontratës, thanë të enjten zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova detyrohet tani t'ia paguajë "Contour Global"-it mbi 20 milionë euro dëmshpërblim në bazë të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Zyrtarët e Ministrisë thanë se Avokatura Shtetërore dhe përfaqësuesi ligjor i kontraktuar e kanë analizuar vendimin final të arbitrazhit dhe se do të ankohen ndaj tij në gjykatën civile në Mbretërinë e Bashkuar.

Në fund të vitit 2017 Qeveria e Kosovës e pati nënshkruar marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane "Contour Global" për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" me kapacitet 500 megavat, i cili do të kushtonte 1.3 miliard euro.

Ky pritej të ishte investimi më i madh i huaj në Kosovë.



Termocentrali "Kosova e Re" ishte paraparë të fillonte të ndërtohej në vitin 2020, ndërsa të vihet në punë në vitin 2023. Jetëgjatësia e tij ishte

llogaritur të ishte 40 vjet. Por, në mars të vitit 2020, kompania "Contour Global" kishte njoftuar tërheqjen nga planet për

ndërtimin e termocentralit, me arsyen se kompania nuk e ka ndër mend të ndërtojë projekte me tërëgjatësi në të ardhmen por, po

ashtu, edhe për arsyeje të ndryshimeve politike që kishin ndodhur në Kosovë.

Asokohe pushtetin në Kosovë e kishte koalicioni qeveritar mes Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Lëvizja Vetëvendosje ishte shprehur kundër marrëveshjes me "Contour Global", duke thënë se një projekt i tillë nuk do të mund të realizohej sepse kompania në fjalë mund ta rriste çmimin e faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike.

Ndërsa Lidhja Demokratike të Kosovës ishte shprehur se do të ndërtonte kapacitete të reja energjetike, por do ta refuzonte secilën alternativë investuese që shtrenjton çmimin përfundimtar të energjisë elektrike prej 100-përqindësh.

Kosova ka më shumë se 10 miliardë tonë linjit dhe, si i tillë, është vendi i pestë në botë për nga sasia e këtij resursi, por edhe pse ka pasuri të linjtit, Kosova vazhdon të përballet me mungesë të energjisë elektrike.

## Bislimi: Kosova po dëshmon angazhimin për avancimin e agjendës evropiane

BRUKSEL, 6 TETOR - Gjatë qëndrimit në Bruksel, zëvendëskryeministri i parë, Besnik Bislimi, ka thënë se Kosova në vazhdimësi po dëshmon angazhimin në avancimin e agjendës evropiane.

Këto komente Bislimi i bëri gjatë një diskutimi me përfaqësues nga Komiteti për Politikë e Siguri (PSC), ku ishin prezentë ambasadorë e përfaqësues të misioneve diplomatike të shteteve anëtare dhe nga BE-ja, thuhet në komunikatën për medie.

Në këtë bashkëbisedim Bislimi prezantoi perspektivën evropiane të Kosovës, përkushtimin e angazhimin tonë për zbatimin e reformave dhe përmbylljen e kritereve. Ai ritheksoi se Kosova mirëpret iniciativën e Komisionit të BE-së për planin e ri për zgjerim prezantuar nga presidentja e Komisionit, Von Der Leyen, si dhe pritshmëritë e Këshillit të BE-së, përfaqësuar nga presidenti i Këshillit, Charles Michel, që zgjerimi të arrihet deri më 2030. "Viti i kaluar ishte vit evropian për vendin, ku u

arrit liberalizimi i vizave dhe u aplikua për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe për anëtarësim në BE. Ndërthurur me rritjen që njohu vendi në zhvillim ekonomik, e suksesin e faktuar në rankime ndërkombëtare në fusha si sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, liria e medieve, u dëshmuua vullneti dhe angazhimi i Republikës së Kosovës në avancimin e agjendës evropiane. Vendi ynë dëshmoi se po performon pozitivisht në indikatorë të ndryshëm përtej barrierave e pengesave me të cilat vendi ynë është përballur", ka thënë Bislimi.

Sa i përket sulmit të Serbisë ndaj Kosovës të dielën e 24 shtatorit, Bislimi tha se atë ditë Serbia orkestroi akt agresioni ndaj Republikës së Kosovës, ku u vra polici, tashmë hero i Kosovës, Afrim Bunjaku. "Faktet e përfshirjes së institucioneve të Serbisë janë të shumta, nga prania e organizimi i agresionit nga Milan Radojiçiqi, prezenca e truporjës së shefit të



BIA-s, Vulin, e deri te mjeti i gjetur e konfiskuar në pronësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, vërtetimi i dhënë nga ushtria serbe

për pajisje me armatim të rëndë, strehimi i terroristëve në Serbi dhe glorifikimi i tyre", ka thënë ai. Zëvendëskryeministri Bislimi i

informoi pjesëmarrësit edhe mbi procesin e dialogut e takimin e fundit të nivelit të lartë mbajtur më 14 shtator.



## Në Prishtinë u mbajt edicioni i dytë i Samitit për Inovacione në Drejtësi

PRISHTINË, 6 TETOR - Këtë vit samiti kishte për qëllim portretizimin e punës së Rrjetit të Inovacionit në Drejtësi gjatë vitit të kaluar. Rrjeti i Inovacionit në Drejtësi është një mekanizëm që bashkon ofruesit e shërbimeve të drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe donatorët ndërkombëtarë, me qëllim të identifikimit të sfidave në Sistemin e Drejtësisë dhe gjetjen e mënyrave inovative për zgjidhjen e tyre. Hapja e edicionit të dytë të këtij samiti u bë nga drejtori i

Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje në USAID, Noel Bauer, ndërkaj fjalimi kryesor u paraqiti nga Albert Zogaj - kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili shpali inovacionet në sistemin gjyqësor të Kosovës përgjatë viteve. Për të shkëmbyer përvoja dhe për t'i parë nga afër inovacionet globale në drejtësi, për të pranishmit nga Uashington DC foli Tom Bridle nga Chemonics International, i cili paraqiti drejtësinë me qytetarin që kjo kompani së bashku me



USAID-in po zbaton në shumë vende të botës.

Në vazhdim të samitit u paraqitën propozimet

inovative të dala nga gara "DevCamp" e zhvilluar në Innovation Centre Kosovo për sistemin e drejtësisë në Kosovë si dhe u mbajt paneli "Proceset e detajuara nga të dhënat që sjellin zgjidhje inovative në drejtësi" me Metihe Kastrati, Arianit Fazliu, Bardhyl Hasanpapaj dhe Betim Musliu. Samiti i Inovacioneve në Drejtësi u përmbyll me prezantimin e punimeve nga nxënësit - drejtësia përmes artit, si dhe punëtoritë e dizajnit të të menduarit, me pjesëmarrësit e samitit.

## Banka Botërore ngre parashikimin për 0.8 % për rritjen ekonomike të Shqipërisë

TIRANË, 6 TETOR - Banka Botërore ka rishikuar rritje 0.8 % për ekonominë e Shqipërisë në vitin 2023, duke projektuar tashmë 3.6 % nga 2.8 % që ishte parashikuar në qershor të këtij viti. "Ekonomia e Shqipërisë ka shfaqur qëndrueshmëri të konsiderueshme kundrejt goditjeve të njëpasnjëshme gjatë periudhës 2019-2022, duke nisur me tërmetin, pandeminë dhe pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Ekonomia shënoi rimëkëmbje të fortë, me një rritje në masën 8.9 % në vitin 2021 dhe 4.8 % në vitin 2022. Normat e varfërisë vijuan trendin rënës edhe përgjatë vitit 2022. Faktor kyç në qëndrueshmërinë e Shqipërisë vlerësohet të jetë afërsia me Bashkimin Evropian, që lehtëson investimet, remitancat dhe eksportet. Ndërtimi dhe turizmi vlerësohen si katalizatorë kyç të rritjes ekonomike", shkruhet në raportin e BB-së.

Referuar zhvillimeve aktuale, BB-ja thekson se indikatorët kryesorë ekonomikë sugjerojnë përshpejtim të rritjes gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë, me numrin rekord të vizitorëve të huaj në korrik 2022 dhe përshpejtimin e aktivitetit të ndërtimit.

Rritja e të ardhurave nga punësimi, rritja e kreditimit, indikatorët e ndjesisë ekonomike të bizneseve dhe konsumatorëve, si dhe të



ardhurat nga taksat sugjerojnë një rritje të mëtejshme në tremujorin e dytë dhe të tretë si pasojë e rritjes së konsumit, investimeve dhe eksporteve. Në raport theksohet se punësimi u rrit 4.4 % në tremujorin e parë 2023. Rritja e pagave dhe punësimi

incentivuan pjesëmarrjen e krahut të punës (mosha 15+) në punësim, e cila arriti në 64 % në tremujorin e parë 2023, shifra më e lartë që nga viti 2019. Nisur nga rritja e fortë e GDP-së për frymë në vitin 2023, varfëria projektohet të zbrësë 1.9 %, duke arritur në 22.2 %.

BB-ja parashikon që rritja ekonomike të jetë 3.6 % në vitin 2023, nisur edhe nga kushtet financiare ndërkombëtare. "Megjithatë, rritja e aktivitetit të turizmit dhe ndërtimit pritet t'i shtyjë përpara eksportet, konsumin dhe investimet në vlera të përafërta me periudhën

para pandemisë. Borxhi publik pritet të zbrësë në nivelin 63.1 % të PPB-së në vitin 2023 dhe projektohet të zbrësë edhe më shumë në afatmesëm si pasojë e rritjes së lartë nominale dhe reduktimit gradual të deficitit fiskal", parashikohet në raportin e fundit të Bankës Botërore.

## Guvernatori i Bankës së Shqipërisë vizitoi Bankën Qendrore të Kosovës

Prishtinë, 6 tetor - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka pritur në takim zyrtar guvernatorin e Bankës së Shqipërisë (BSH), Gent Sejko. Guvernatori Sejko vizitoi BQK-në, e uroi edhe personalisht për detyrën guvernatorin Ismaili dhe i ofroi bashkëpunim dhe mbështetjen e tij. Guvernatori Ismaili e

falënderoi guvernatorin Sejko për bashkëpunimin e deritashëm të ofruar nga Banka e Shqipërisë për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Në takim u diskutua lidhur me mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm të BQK-së dhe BSH-së në sektorin financiar, duke përfshirë aktivitete të përbashkëta për edukimin

financiar dhe bashkëpunimin regional. Në këtë takim u tha se bashkëpunimi ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës së Shqipërisë do të zgjerohet edhe më tutje me qëllim të krijimit të praktikave më të mira ndërmjet dy vendeve me përfitime për sisteme financiare dhe ekonomitë e dy vendeve.





# Strategjia e Serbisë kundër Perëndimit përmes Kosovës



**Hajdin ABAZI**

Kur dy ditë pas përpjekjes për organizim të kryengritjes së armatosur në Kosovë kam publikuar shkrimin, nuk i kam pasur informacionet që tashmë janë bërë të njohura për opinionin, sidoqoftë konstatimi i shprehur është real: 24 shtatori është një momemtum i ri.

Ky momentum i ri është, para së gjithash, për Kosovën, por edhe për ShBA-në, BE-në dhe NATO-n, sepse të gjithë këta faktorë janë të ndërlidhur dhe të afektuar drejtpërdrejt e tërthorazi. Ajo çfarë ka ndodhur midis Kosovës dhe ShBA-së, para së gjithash dhe sidomos gjatë këtij viti, deri te 24 shtatori, ishte një vetëgoditje, një sjellje e qëndrim i gabuar i pushtetarëve, që ishte duke çuar në ngrirjen e raporteve ndaj Kosovës në vend se të bënte krejt të kundërtën: t'i kultivonte e përforconte ato.

Kosova realisht ishte në një pozitë shumë të keqe saqë edhe u sanksionua dhe kishte rrezik për rigjenerim të sanksioneve edhe më tej, bukur shumë me fajin edhe të Kosovës që nuk gjeti dot mënyrën e bashkërendimit me ShBA-në me gjithë insistimin e kësaj. Marrëdhëniet me sponsorizuesin e shtetit të Kosovës, pra me ShBA-në, politikisht arritën thujtë në pikën e ekskomunikimit. Ky duhet të jetë një leksion politik dhe historik, që kurrë më të mos përsëritet!

Por Beogradi zyrtar u vetëdemaskua. Dhe kjo ishte e pashmangshme. Sepse sjellja gjoja konstruktive dhe e gjoja përkushtimit për zgjidhje paqësore me Kosovën përmes dialogut, ishin farsë, njëllj sikurse kanë qenë që nga fillimi. Ato ishin një maskë, sa për të futur në kurthe Perëndimin, ashtu që të fitonte legjitimitet ndërhyrja ushtarake në Kosovë. Kjo aspiratë që zanafillën e ka ndër shekuj dhe e pashuar as pas bombardimeve të NATO-s, mbetet konstante e shovinizmit politik të Beogradit, dhe pikërisht kjo, herët a vonë, do të bënte të hiqej çirrej maska gjoja-perëndimore e të dilte në shesh fytyra e vërtetë si mashë ruse kundër gjeopolitikës euroatlantike.

\*

Pas 14 shkurtit 2021, Kosova ra gradualisht në kurthin e Serbisë që kulmoi pas zgjedhjeve lokale

në veri, pasi që gradualisht e kontestoi besimin ndaj ShBA-së deri në mosdëgjim të hapur e veprim ndryshe. Duke e parë se ku po rrëshqitte Kosova, Vuçiq kishte filluar të luante rolin e ujkut të zbutur, që ishte i interesuar për zgjidhje, për koordinim e thujtë edhe për bashkërendim me ShBA-në, BE-në dhe NATO-n, por disi në mënyrë të ndrojtur për shkak se ishte i kanosur drejtpërdrejt nga Rusia.

Serbia kishte arritur të paraqiste kryeministrin Kurti me një pamje të stërkequr, sikur gjoja po instalonte politika luftënxitëse ndaj minoritetit serb, që nuk ishte e vërtetë dhe nuk është e vërtetë. Por ftohja e tij ndaj sponsorëve të çlirimt dhe të shtetit të Kosovës, i krijoi rrethana Vuçiqit dhe politikëbërësve në Beograd të krijonin një perceptim sikur po synohej persekutimi i serbëve. Kjo i dha kredi Vuçiqit që çdo kriminel luftë (1998-1999), si dhe çdo kontrabandist, paramilitar e çdo kriminel, ta paraqiste sikur po përndiqej gjoja mbi baza etnike. Krimin, kontrabandën, veprimet paramilitare i bëri sinonim me qytetarë të thjeshtë serbë që nuk ishin askund të inkriminuar, por që shteti i Kosovës po i ndiqte politikisht dhe po bënte spastrim etnik. Kjo, absolutisht, ishte e pavërtetë. E vërteta ishte se kështu Serbia po mobilizonte këto kategori për t'i hedhur në veprime radikale, sikurse kishte bërë vazhdimisht, por tash edhe në forma gjoja guerile. Qeveria e Kosovës në pozicionin e ngurtë që kishte krijuar dhe sidomos me diskrepancën me ShBA-në, kishte bërë gabimin trashanik që i krijoi Serbisë kondita për t'ia mjegulluar perceptimin perëndimit. Sigurisht, ShBA-ja ka interes strategjik ndaj Serbisë për ta inkuadruar në botën perëndimore, e për ta larguar nga aleanca ruse, veçse askujt nuk i beson blanko por ka sistemin dha kapacitetet e kontrollit që edhe t'i shohë se sa janë konsequentë në përmbushjen e asaj që deklarohet e pretendohet, por edhe t'i ndalojë.

\*

Po të mbetet Serbia në terrenin politik, realisht, rrjedha e zhvillimeve ishte duke shkuar në favor të saj dhe disfavor të Kosovës.

Por shovinizmi serb nuk njihet kufij dhe arsye politike, sepse është i pangopur dhe është infektuar në mënyrë kancerogjene nga metafizika shoviniste e teologjike, të ndërlidhura e të kondicionuara në mënyrë të ndërsjellë, në linja të njëjta me atë të Ruisë, kundër

Perëndimit dhe kundër fqinjëve, posaçërisht kundër shqiptarëve. Në fund të fundit, duket se Beogradi ra në kurthin që ia ngriti Kosovës dhe Perëndimit. Beogradi kalkuloi gabim se ka arritur t'ia eklipsojë perceptimin Perëndimit dhe se qëndrimi i Perëndimit ndaj Kosovës ishte përqësuar deri në kufijtë thujtë kritik, dhe pikërisht gjatë kësaj kohe sa po ndodhte kjo stërkeqje faktike - Beogradi zyrtar kishte investuar në përgatitjen dhe stërvitjen e grupeve agresioniste. Në krye vendosi njeriun e besueshëm të Vuçiqit dhe të inkriminuar në biznes, kërcënime, shantazhe e vrasje edhe të vetë serbëve në Kosovë - Milan Radojçiqin. Pasi kishte krijuar perceptimin e gjoja një represioni (pa asnjë fakt real) ndaj minoritetit serb, besoi se kishte krijuar klimën e duhur që Perëndimi të toleronte veprime për kryengritje të armatosur në Kosovë me synim aneksimin e veriut si ndërhyrje shpëtimtare për minoritetin - taktikë kjo e njëjtë me atë që Putin e ndoqi në luftën pushtuese në Ukrainë shkurtin e vitit 2022.

Kur Serbia po paraqitej si dele, nëntokë dhe prapa shpinës së Perëndimit po përgatiste një sulm ndaj Kosovës, por për shkak të pozicionit specifik, çdo sulm ndaj saj është njëherit edhe sulm ndaj NATO-s, ShBA-së dhe BE-së.

\*

Nuk ka dyshim se kishte një skenar, me disa faza, që nuk është zor të merren me mend. Faza e parë ishin riorganizimi i paramilitarëve të "Mbrotjes Civile" dhe "të Brigadave të Veriut" në grup militar, të stërviteshin si grupe gjoja-guerile, me mbështetje ekspertësh ushtarak dhe armatim nga Serbia. Se ishin diversionistë e tregon fakti se u tërhoqën në Serbi, dhe janë të vendosur atje, e madje Serbia nuk i arreston por i lë të lirë, madje edhe duke i trajtuar si heronj.

Faza e dytë ishte futja e diversioniste në territorin e Kosovës, për t'u dislokuar në pozita strategjike, natyrisht pasi që më parë kishin kontrabanduar armë e automjete ushtarake, dhe të niste marrja e kontrollit mbi territorin verior të Kosovës. Faza e tretë ishte involvimi i manastirit të Banjskës, qoftë për të krijuar perceptimin në popullatën serbe se kisha është mbështetëse e tyre, por edhe që të përqendrohej aty kundërveprimi mbrojtës i Kosovës, e që para botës të paraqitej si sulm ndaj kishave serbe.

Faza e katërt, do të ishte

përhapja e lëvizjes guerile edhe në pjesë të tjera, që do të çonte kah pushtimi i veriut, e që Beogradi dhe diplomacia serbe do ta mbështesnin si gjoja mbrojtje nga "represioni" i Kurtit, gjithnjë duke e akuzuar Kosovën se ajo e përqësosi gjendjen sa të mbetet e vetmja rrugë kryengritja e armatosur e minoritetit serb, sepse Kosova nuk pranonte zgjidhje politike. Faza e pestë do të ishte shpallja e një republike serbe në Kosovë, e pasuar nga ftesa e qeverisë së saj drejtuar Serbisë për ndihmë ushtarake dhe eventualisht futja e ushtrisë serbe në Kosovë (reprizim i veprimit të Putini në Ukrainë). Kjo mund të shkonte deri atje, sa të ftohej Rusia për të dërguar trupa në mbështetje të Serbisë, me çka do të krijohej një vijë frontale midis Perëndimit dhe Ruisë, diçka ngjashëm sikurse ishte Muri i Berlinit si kufiri ndarës midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës.

Ky skenar parashihte involvimi e ushtrisë serbe, të inteligjencës serbe, të mercenarëve të Wagnerit e të kriminelëve të tjerë, të cilët disa herë ishin futur ilegalisht nga Serbia në Kosovë dhe kishin vepruar herë pas here por në mënyrë të veçantë u treguan shumë aktiv në konfliktet e tyre kundër KFOR-it në fundmaj e fillimqeshor të këtij viti, e që vet ky ishte një skenar tjetër nga presidenti serb Vuçiq.

Fazat e skenarit mund të ndërthureshin në zbatim e sipër me një shpejtësi varësisht nga zhvillimet, por ja që krejt ato u shembën më 24 shtator nga që Kosova veprroi shpejt dhe me efikasitet.

Beogradi zyrtar me veprimet e dhunshme që i kishte inkurajuar kundrejt KFOR-it kishte treguar se i dirigjon ato, i nxit ose i frenon me ritmin që ka në mashtrimin strategjik ndaj Perëndimit, por gjithnjë me taktika dhe strategji që nuk ofrojnë zgjidhje por e acarojnë gjendjen, duke ia hedhur fajin gjithnjë Kosovës, dhe duke kërkuar përkrahjen e Perëndimit ndaj "qasjes represive" të Kosovës. Në të vërtetë, Kosova kishte bërë gabime që nuk ishte bashkërenduar me ShBA-në, por absolutisht dhe në asnjë rast, asnjëherë që nga paslufta e deri më sot, nuk kishte tejkuluar policia e Kosovës sjelljen profesioniste dhe të fokusuar vetëm ndaj të inkriminuarve, madje jo rrallë edhe duke mos marrë veprime vetëm që të mos përfshihej edhe ndonjë civil i pafajshëm, me objektivin e qartë edhe për të diferencuar e mbrojtur qytetarët e pafajshëm, edhe për t'i treguar botës se Kosova është e kujdesshme.

\*

Grupi agresionist që u fut në Kosovë, nuk kishte asnjë element të një strukturë çlirimtare. Unë vet kam qenë ushtar i UÇK. Por kurrë nuk do t'i isha bashkëngjitur një "lëvizje çlirimtare", sikur ajo të udhëhiqej nga një kriminel luftë, kontrabandist e organizator vrasjesh si soji i M. Radojçiqit. Një miliardër që pasurinë e vet e ka bërë me inkriminime nga më të ndryshmet, nuk është kredibil për të qenë në krye të një lëvizjeje çlirimtare. Por me sa duket, Vuçiq nuk ka gjetur njeri më të besueshëm për këtë mision. Dhe kjo e shpreh krejt karakterin "çlirimtar". Një njeri që është përgjegjës për mbajtjen e minoritetit serb nën shantazh, presion dhe që ka organizuar edhe kërcënime e vrasje të serbëve, nuk ka asnjë premisë reale të jetë një luftëtarë lirie. Lufta për liri kërkon ideale çlirimtare, kur njeriu duhet të jetë i gatshëm të flijojë edhe jetën për ato ideale, të shpenzojë pasurinë që ka dhe jo të bëhet miliardër; të kundërtën kanë bërë dhe bëjnë vetëm profiterët e luftës.

\*

Vuçiq duket qartë se ishte udhëhequr nga profetizimi i Dobrica Qosiç, i cili kishte shkruar se Serbia mund të ketë shanse për ta rikthyer Kosovën vetëm kur të arrijë ta armiqësojë atë me Perëndimin dhe sidomos me ShBA-në, dhe kjo ishte arritur deri diku gjatë këtyre dy viteve të fundit. Por, me këtë rast, ishin harruar aspektet e tjera që Perëndimi dhe sidomos ShBA-ja i kishin me Kosovën, ndër të cilat gjeopolitika euroatlantike.

Beogradi zyrtar duket se i ka keqperceptuar qëndrimet e ShBA-së dhe të KFOR-it e të BE-së lidhur me Kosovën. Sanksionet që iu vendosën Kosovës kishin të bënin me mosdëgjueshmërinë e qeverisë Kurti ndaj ShBA-së, por nuk ishte tregues se ShBA-ja e kishte hequr nga sfera e interesit dhe e gjeostrategjisë së saj, gjë që e kishte theksuar disa herë.

Në të vërtetë, Kosova është pjesë e gjeostrategjisë amerikane dhe euroatlantike, e Serbia pjesë e gjeopolitikës ruse. Sjellja me tolerancë dhe sidomos sinkronia e ShBA-së dhe e BE-së ndaj Serbisë ishte përpjekje për ta larguar atë nga Rusia, që me sa duket kishte dhënë shenja se ka një gatishmëri vetëm se i duhet shtytja e perëndimit dhe sidomos koncesionet lidhur me asociacionin e komunitetit serb, i cili duhet të merrte tipare autonomiste e madje ajo mund të rritej edhe më shumë, sikurse e tha edhe kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të



Bundestagut gjerman - në një strukturë federale. Deri këtu degradoi humbja e besimit ndaj Kosovës dhe deri këtu arriti mashtrimi i Serbisë ndaj Perëndimit.

ShBA-ja dhe Perëndimi nuk është i gatshëm të krijojë edhe një "vrëmë të zezë" të gjeopolitikës ruse në kontinentin e Evropës, sepse do të ishte tepër e rrezikshme për paqen, sigurinë dhe stabilitetin e kontinentit. Prandaj, masat ndaj Kosovës tregonin se i kërkohej bashkërendim për të shmangur atë që dëshironte Serbia, që kjo vrëmë potencialisht e zezë të mos aktivizohej në funksion anti-Evropë e anti-Perëndim.

Konsekuenca gjeostrategjike dhe gjeopolitike euroatlantike ndaj Kosovës nuk ka ndryshuar asgjë, prandaj ShBA-ja, Britania e Madhe dhe Gjermania ishin të zëshme dhe decidive kundër veprimeve e të cilat i dënuan, por edhe i kërkuan pa ekuivokë asaj që të largonte ushtrinë nga kufiri i Kosovës.

Serbisë mund t'i bëhej ndonjë koncesion politik lidhur me minoritetin serb në Kosovë, por jo koncesion që e godet strategjinë euroatlantike. Por kjo nuk i mjaftonte Serbisë, ashtu sikurse Asociacionin e kishte vetëm pretekst, për ta shndërruar në një shtet të dytë në Kosovë. Veprimet e të sponsorizuara nga Serbia që godisnin sa Kosovën aq dhe NATO, ShBA-ja dhe BE-ja, treguan qartë se Serbia ua kishte hedhur, se ajo tjetër gjë deklaronte në tryezën e bisedimeve e tjetër gjë vepronte; thjesht se Serbia ishte inkonsuesja e gjithçkaje të keqe që kishte ndodhur në veri, në emër të gjoja minoritetit serb.

\*

Shovinizmi serb, aktualisht varianti i Vuçiqit, është tepër perfid, nuk ka forcën shpirtërore të shoh të vërtetën në sy, dhe të reflektojë. Ai dëshiron ta ndryshojë të vërtetën sipas interesave kundër shqiptarëve, e atë pastaj ta njohë si të vërtetë, ani se do të ishte një e vërtetë e përmbysur. Ai nuk e kupton se rrjedhat e historisë i kanë pleksur interesat strategjike të shqiptarëve dhe të ShBA-së e të euroatlantizmit.

Shovinizmi serb nuk mund të çlirohet nga sëmundja e vet kancerogjene si për shkak të metafizikës politike ashtu edhe për shkak të ndikimit religjioz, të cilat ndërliiden, mbështesin njëra-tjetrën dhe kondicionohen në mënyrë të ndërsjellë.

Shovinizmi serb, gjithsesi, ndonëse synon të paraqitet, nuk është vetë populli serb, dhe këtë e tregojnë zërat serbë që e kundërshtojnë shovinizmin, veprimet agresive, politikën mashtruese të Vuçiq - janë dëshmi se njerëzit racional janë të shtypur nga pushteti, pa mundësi për t'u artikulluar dhe për të ndikuar në politikën e Serbisë. Shumica e qytetarëve

serbë në Banjskë deklaruan se nuk dinin se çfarë kishte ndodhur më 24 shtator, që flet shumë për karakterin e kontrabanduar "importues".

Edhe më e rëndë është gjendja e minoritetit serb në Kosovë: ai mbahet peng nga Beogradi zyrtar, si dhe përmes mekanizmave politikë e paramilitarë të krijuar e të dirigjuar nga Beogradi. Ai ka nevojë të çlirohet, po njëmend të çlirohet, ama nga shovinizmi serb dhe nga presioni e shantazhet e Beogradit. Një serb e tha: ai dhe familja e tij, ndonëse mund të tingëllojë paradoksale, është më e sigurt në Kosovë se sa në Serbi. Kjo është e vërtetë, sepse në Kosovë edhe po të jesh kundër qeverisë, nuk ndiqesh, nuk persekutohesh e arrestohesh më motive politike apo etnike, kurse në Serbi po. Thuajse secili serb që ka dashur të bashkëpunojë me institucionet kosovare, pra të integrohet në lirinë e Kosovës ashtu sikurse kanë bërë të gjitha komunitetet e tjera, sapo të hyjë në kufirin e Serbisë - ndalohet, merret në pyetje, shantazhohet, i bëhet presion, arrestohet e dërgohet në burg.

Prandaj, problem kryesor për Serbinë është fryma shoviniste, dhe kjo është një çështje në të cilën Perëndimi duhet të punojë me strategji afatgjate, për të mbështetur forcat properëndimore në Serbi e në Kosovë, të cilët e kanë kuptuar të keqen e madhe të shovinizmit dhe duan ta heqin qafe atë e të përvetësojnë frymën evropiane, dhe këta mund ta shërojnë Serbinë nga sëmundja e shovinizmit e si rrjedhojë do të hiqej edhe "pushtimi virtual e real" i minoritetit serb në Kosovë.

\*

Se Vuçiq nuk ka të njëjtat vlera euroatlantike ose Perëndimore mund të konstatohet edhe nga diçka periferike. Përderisa Perëndimi, konkretisht ShBA-ja, Britania e Madhe, BE-ja e NATO-ja - nderuan policin Afrim Bunjaku që u vra në krye të detyrës, e që ishte respekt për forcat e sigurisë së Kosovës në mbrojtje të integritetit territorial por edhe në funksion të gjeostrategjisë euroatlantike kundër grupit agresionist që provoi të instalonte një kryengritje. E Serbia bëri të kundërtën: shpalli tre ditë zie për ata që u vranë në aktet terroriste. Në fakt, kjo nuk është befasi, sepse Serbia gjithnjë politikisht i ka glorifikuar kriminelët si heronj, dhe kështu bën edhe tash. Më këtë dëshiron ta infektojë popullin serb përgjithësisht, se shovinizmi edhe kur arrin në shkallë terrorizmi duhet të përkrahet e të konsiderohet si akt heroik. Për më tepër, ky glorifikim i inkurajon të tjerët, sepse shteti serb po i përkrah dhe po i vlerëson në rangun e heronjve, ani se, ç'është e vërteta, ata janë pseudo heronj. Dhe gjyqi ndaj

Radojçiqit nxori faktin se politika e Beogradit qëndron pas Radojçiqit: edhe pse ai pranonte se ishte pjesëmarrës në vrasjen e policit Afrim Bunjaku, ai lihet i lirë, ashtu si edhe agresionistët e tjerë.

E kam shkruar edhe më herët, se çështja e minoritetit serb në Kosovë është çështje politike dhe vetëm politika mundet të ofrojë zgjidhje. Këtë ishte duke e arritur më shumë sukses Beogradi, pasi që kishte arritur ta fuste nën hipnozën e mashtrimit Perëndimin, e duke menduar se i hipnotizoi deri në manipulim - do të tolerohej edhe organizimi i një luftime aneksionuese me të cilën synonte të shkakonte një çarje të gjeopolitikës euroatlantike dhe kjo nuk ka gjasa të tolerohet. Me këto veprime Vuçiq u tregua, ashtu sikurse ishte në të vërtetë, një politikan të cilit nuk duhet aspak t'i besojë Perëndimi, në asnjë rrethanë. ShBA-ja, Britania e Madhe e Gjermania, por besoj edhe BE-ja dhe NATO-ja, nuk duhet t'i besojnë më Vuçiqit ashtu sikurse nisën t'i besojnë sidomos gjatë gjysmës së parë të këtij viti.

\*

Pastaj, dislokimi i forcave luftarake serbe përgjatë kufirit të Kosovës nuk ishte aspak rastësi. Përkundrazi. Ajo ishte paralajmëruar nga shumë anë e sidomos nga banderolat e sponsorizuara "Kur ushtria serbe të kthehet në Kosovë". Pra, po trumbetohej hyrja invaduese. Ushtria ishte lëvizur pa zhurmë, disi në fshehtësi, dhe ishte vendosur përgjatë kufirit me Kosovën.

Serbia kalkuloi gabim. Sepse siguria e Kosovës i ka tre aktorë veprimi: policinë e Kosovës, EULEX-in e pastaj edhe KFOR-in. Natyrisht, sikurse e tha KFOR, këto veprime nuk janë të ndara, por ndërvepruese. Në aksionin e policisë në shpërbërjen e grupit, prezent ishte edhe EULEX e edhe KFOR, në cilësinë e vëzhguesit, por edhe të gatshëm për të intervenuar po qe se aktori i parë (policia e Kosovës) nuk do të kishte sukses. (Me gjithë këtë mbikëqyrje ndërkombëtare dhe Serbia nuk pushon propagandë të gjithfarshme për ta përmbysur të vërtetën, po mund të mendohet se sikur të mos ishin EULEX dhe KFOR se si do ta bombardonte Perëndimin Serbia me dezinformata, gënjeshtër e terror të trilluar.)

Vuçiq po e përdor tash Radojçiqin për të spastruar Serbinë nga involvimi, sikur gjoja gjithçka është bërë përmes kontrabandimit nga Bosnjë-Hercegovina.

Por dokumentacioni i kapur me rastin e shpërbërjes së grupit tregojnë se furnizimi ishte bërë nga ushtria serbe. Pastaj, automjeti ushtarak Humvee, që amerikanët ia dhuruan ushtrisë serbe, si ra në duart e grupit agresionist? Atij i janë dhënë këto, se nuk ka pasur ndryshe se si t'i

merrte ato kur ishin në posedim të ushtrisë. Pastaj tabelat KFOR, për të mashtruar popullatën gjoja se janë pjesëtar të KFOR-it. Sigurisht, ende ka shumë të dhëna që mungojnë dhe detajet ndoshta kurrë opinioni nuk do t'i mësojë, por ato i dinë me saktësi ShBA-ja, Britania e Madhe dhe Gjermania, por edhe NATO-ja dhe BE-ja.

Të gjitha këto, janë fakte kokëforta, ashtu sikurse edhe janë xhirimet nga dronët e konfiskuara te M. Radojçiqit, ku shihen stërvitjet dhe përgatitjet për aksione masive. E shtoji kësaj edhe armatimin masiv, që asnjë gjeile e vërtetë nuk do të mund t'i kishte që në fillim po qe se nuk do të mbështetej nga shteti. UÇK-ja as pas një viti të ekzistencës së saj nuk kishte një armatim dhe mjete të tilla, sepse nuk kishte asnjë mbështetje ushtarake nga asnjë shtet.

\*

Duket se Kosova ka pasur informacione paraprake (le të sillet ndërmend se tre muaj më parë G. Escobar kishte dhënë alarmin se veriu mund të kthehej në "një konflikt rajonal", kurse A. Kurti i tregonte ShBA-së gjëra që ajo nuk i dinte se nuk ka gjasa për një konflikt rajonal!). Por, organet e sigurisë ndryshe i shohin gjërat, ndaj dhe nuk u zu në befasi Kosova, po veprimi me shpejtësi. Përderisa politika po tallej me ShBA-në, organet e sigurisë ishin në krye të detyrës, sepse ua imponon natyra e punës që të nuhasin rrezikun dhe t'i kapin informatat mbi rrezikun. Prandaj, është gabim të thuhet se ra Banjska e u pa se kush janë aleatët e vërtetë të Kosovës; kjo mund të vlejë: për ata që nuk e kanë ditur për shkak të padijes së vet. Kushdo që ka pasur dyshime te ShBA-ja se mos ka ndryshuar anë e kishte gabim, pasi që gjeopolitika euroatlantike e ShBA-ja ishte e tillë nga fillimi dhe zhvillimet që pasuan, sidomos me sulmin rus ndaj Ukrainës, vetëm sa e përforconin aleancën e ShBA-së me Kosovën. Vazhdimisht e kanë theksuar ambasadori J. Hovenier, emisari G. Escobar dhe personalitete të tjera nga Departamenti amerikan i Shtetit se ShBA-ja nuk bën asgjë që do të dëmtonte Kosovën, dhe kjo kishte një bazë të fortë: çdo dëmtim i Kosovës në aspektin shtetëror ishte dëmtim njëkohësisht i gjeopolitikës dhe gjeostrategjisë amerikane dhe euroatlantike, dhe do të ishte një mjet në duart e Serbisë dhe veglave të saja kundër Kosovës po se po por edhe kundër gjeostrategjisë euroatlantike e në funksion të gjeopolitikës ruse - sa herë që kjo t'i duhej.

Por këmbëngulja amerikane, britanike dhe gjermane për tërheqjen e ushtrisë serbe nga kufiri i Kosovës dhe për dënimin e aktit terrorist - do të duhet t'u kenë hequr dilemat të gjithë skeptikëve, dyshuesve dhe atyre që mendonin (krejt gabimisht) se ShBA-ja po e dëmtonte Kosovën në ndonjë mënyrë. Kushdo që, për

çfarëdo shkak, mendon të mos bashkërendohet në çdo detaj dhe për gjithçka me ShBA-në - bën gabim në dëm të Kosovës. Sjellje të tilla në emër të Kosovës nuk është dashur të ndodhin asnjëherë, por më nuk guxojnë më të përsëriten.

Pas një periudhe thauja dy vjeçare me politikë reaktive, momentumi i krijuar më 24 shtator sugjeron se diplomacia kosovare duhet të shndërrohet në proaktive. Politika e jashtme duhet të fokusohet për të kërkuar nga faktori ndërkombëtar që ta ekstradojë në Kosovë grupin agresionist që ikën në Serbi; të kërkojë përgjegjësi për furnizimin me armatim ushtarak nëntokës së inkriminuar në Kosovë; të kërkohet më këmbëngulje që Serbia të mos ndërhyjë as drejtpërdrejt e as në ndonjë mënyrë në çështjen e minoritetit serb duke argumentuar se është Beogradi zyrtar ai që ka nxitur e orkestruar protestat pa asnjë bazë kundër policisë së Kosovës e KFOR-it, por edhe që të heq dorë nga mbështetja e forcave paramilitare serbe në Kosovë, si dhe përgatitjen e tyre të mëtutjeshme për aksione e. Duhet t'i kërkohet përgjegjësi Vuçiqit dhe qeverisë serbe që ka penguar dhe po vazhdon ta pengojë minoritetin serb që të integrohet në jetën kosovare, në lirinë si të gjitha minoritetet e tjera dhe që ata të integrohen në sistemin dhe shoqërinë kosovare si qytetar dhe shtetas të Kosovës.

Nga e tërë kjo që ka ndodhur, Kosova duhet të ketë mësuar se vetëm kur bashkërendohet me ShBA-në, edhe kur duket se po i del keq, në të vërtetë është e vetmja mundësi për ta shmangur të keqen. Ne duhet të jemi fatlum që Kosova ka një mbështetje kaq të fortë të ShBA-së, dhe që fati na ka vënë në sferën amerikane dhe të gjeopolitikës euroatlantike.

\*

Perëndimi, e sidomos ShBA-ja, Britani e Madhe dhe Gjermania, ashtu si edhe shumë vende të tjera të BE-së dhe të NATO-s, duhet të ndalen dhe ta rimendojnë politikën dhe qëndrimet ndaj Vuçiqit. Më qartë se kaq nuk ka se si të tregohet se ai është në gjendje t'ua ngulë thikën pas shpinës, se nuk mund t'i besohet, se ai do t'ua hedhë gjithë aty ku më së pakut e presin. Duhet t'i vihen vijat e kuqe, si sa i përket gjeopolitikës euroatlantike, ashtu edhe ndaj ndërhyrjeve në Kosovë. E kam thënë më herët, se përpjekja për ta integruar Serbinë në gjeopolitikën euroatlantike është e dobishme edhe për Kosovën, gjithsesi në çdo rrethanë, por 24 shtatori tregoi se me shovinizmin dhe ideologjinë antiperëndimore të Vuçiqit - kjo është e pamundur të arrihet. Besoj tash Perëndimi, përfshirë edhe BE-në, duhet t'i vendosë sanksione Serbisë, përndryshe, nëse kjo nuk ndodhë, nga Beogradi kjo do të interpretohet si tolerim për një front të dytë luftë proruse kundër BE-së.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

# SPORT



## Kosova me risi për ndeshjet e tetorit, mungon Rrahmani

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për ndeshjet e muajit tetor. Kosova më 12 tetor në udhëtim përballet me Andorrën, derisa tri ditë më vonë e pret Izraelin në stadiumin "Fadil Vokrri". Risi në listën e Kosovës janë futbollistët e ftuar nga Superliga e Kosovës: Ilir Krasniqi (Llapi), Lumbardh Dellova dhe Qëndrim Zyba (Ballkani), kurse është ftuar edhe Shkëlqim Vladi që është pjesë e Luganos në Zvicër. Mungesa më e madhe për këto ndeshje është ajo e kapitenit Amir Rrahmani si dhe e mbrojtësit të Torinos, Mërgim Vojvoda. Po ashtu, nuk

janë ftuar edhe Arbër Zeneli, Valon Berisha, Ermal Krasniqi dhe Ibrahim Dresheviq. "Dardanët" nuk e kanë aspak mirë gjendjen në Grupin I, pasi ëndrra për kualifikim në Kampionatin Evropian thuajse ka përfunduar. Deri tash Kosova ka regjistruar tri barazime dhe dy humbje, derisa është ende në kërkim të fitores së parë.

**Lista e futbollistëve:** A. Muriq, V. Bekaj, S. Ujkani, L. Paqarada, F. Hadergjonaj, K. Hajrizi, L. Kastrati, F. Aliti, I. Beka, B. Fazliji, I. Krasniqi, L. Dellova, F. Loshaj, Q. Zyba, F. Muslija, M. Korenica, E. Zhegrova, M. Rashica, B. Berisha, E. Rashani, A. Zeqiri, Z. Bytyqi, V. Muriqi, A. Rrahmani, Sh. Vladi.



## Prishtina - Drita, derbi i Superligës

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Xhiroja e nëntë e Superligës së Kosovës në futboll do të zhvillohet në këtë fundjavë ku do të këtë edhe ndeshje derbi. Sot (e shtunë) do të zhvillohet ndeshje mjaft e fortë në mes të Malishevës dhe Dritës, që pozicionohen në pozitën tre dhe katër. Të dyja këto skuadra, pasi në xhiron e kaluar shënuan fitore ndaj Gjilanit, përkatësisht Lirisë, tash që të dyja synojnë fitore edhe në këtë ndeshje. Sot këndelljen e kërkon Gjilani ndaj Dukagjinit të Klinës, kurse skuadrat në pjesën e poshtme të tabelës, Feronikeli dhe Fushë-Kosova, do të përballen në Drenas. Të dielën zhvillohet derbi i xhiron në mes të Ballkanit dhe Prishtinës.



Kampionët e Kosovës po shkëlqejnë edhe në Ligën e Konferencë. Të enjten e mposhtën Dinamo Zagrebin (2-

0), ndërsa me këtë formë të mirë synojnë ta vazhdojnë edhe kundër klubit më të trofeshëm në Kosovë. Kryeqytetasit

aktualisht janë në pozitën e pestë në tabelë dhe në këtë ndeshje do të hyjnë për rezultat pozitiv në mënyrë që të ngrehen në

renditjen tabelore. Fitore të dielën kërkon edhe skuadra e dytë në elitë, Llapi, që e pret Lirinë e Prizrenit në stadiumin "Zahir Pajaziti". Llapjanët kanë 16 pikë nga tetë ndeshjet e zhvilluara, derisa prizrenasit kanë dhjetë pikë më pak dhe janë të parafundit në renditjen tabelore. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 15:00.

### SUPERLIGA - Java e 9-të

**Të shtunën takohen:**  
Feronikeli 74 - Fushë-Kosova  
Gjilani - Dukagjini  
Malisheva - Drita

**Të dielën takohen:**  
Prishtina - Ballkani  
Llapi - Liria

## Sot përballen Vëllaznimi - Prizreni, derbi zhvillohet të enjten

**PRISHTINË, 6 TETOR** - Java e tretë në Prince Caffë Superligë pritet të dhurojë sfida shumë interesante. Derbi i kësaj xhiroje është ndërmjet Pejës dhe Trepçës, por kjo sfidë do të zhvillohet të enjten me pajtimin e dy klubeve. Ky është një ballafaqim mes kampionit dhe fitueses së Kupës dhe Superkupës së Kosovës, si dhe dy skuadrave me traditë në basketbollin e Kosovës. Po ashtu, të dyja skuadrat e kanë nisur kampionatin shumë mirë, me dy fitore në dy ndeshje. Takimi hapës i kësaj xhiroje është

ndërmjet Vëllaznimit dhe Proton Cable Prizrenit, ku dy skuadrat kërkojnë fitoren e parë në këtë edicion, pasi e nisën me dy humbje. Sfidë shumë me interes është ajo ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit. Të dyja skuadrat kërkojnë fitoren e dytë këtë edicion, sepse kanë nga një fitore e një humbje. Të dielën do të ndeshen edhe Istogu me Bashkimin. Për istogasit kjo është hera e parë që luajnë në elitë dhe janë në kërkim të fitores së parë, kurse prizrenasit duan fitoren e tretë në tri ndeshje.

### SUPERLIGA - Java e 3-të

**Të shtunën takohen:**  
19:00 Vëllaznimi - Proton Cable Prizreni

**Të dielën takohen:**  
17:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli  
19:00 Istogu - Bashkimi

**Të enjten takohen:**  
18:00 Peja - Trepça





## Nadali pas tetë muajsh rikthehet në stërvitje

MADRID, 6 TETOR - Tenisti spanjoll Rafael Nadal ka rinisur stërvitjen, duke iu rikthyer fushës së lojës gati tetë muaj nga hera e fundit. I dëmtuar në raundin e dytë të grand slam të Australian Open, spanjollit synonte të rikthehej në Roland Garros,

po dëmtimi ishte më i rëndë nga parashikimi. Kështu, në pranverë, Nadal konfirmoi se sezoni 2023 për të ishte i mbyllur, duke mos luajtur më në asnjë turne. Për pasojë, 37-vjeçari aktualisht ndodhet në vendin e 240 të renditjes botërore. Gjithsesi,

duket se situata tani është ndryshe. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Nadal ka marrë sërish raketën në dorë dhe po stërvitet në mjediset e akademisë së tij në Majorka. Dhe Nadal duket i karikuar për t'u rikthyer protagonist në fushë. Edhe

pse jemi ende në tetor, vështirë se Nadal do të luajë ndonjë ndeshje këtë vit. Pritet që fituesi i 22 grand slameve të rikthehet në Australian Open, aty ku u dëmtua këtë vit, ndërkohë që objektivi është fitimi i Roland Garros.



## Sylvinho publikon listën e futbollistëve, rikthehet Broja

TIRANË, 6 TETOR - Më 12 tetor në "Air Albania" Shqipëria luan finalen e radhës, më të rëndësishmen, teksa pret Republikën Çeke, një ndeshje që pritet të vendosë shumë mbi kualifikueset "Euro 2024". Trajneri Sylvinho ka publikuar listën me lojtarët që do të ketë në dispozicion për këtë takim, por edhe për miqësoren me Bullgarinë. Në listën e përbërë nga 25 futbollistë ka ndryshime të pakta në krahasim me sfidat ndaj Çekisë dhe Polonisë në shtator. Rikthehet me Kombëtaren sulmuesi Armando Broja, i cili e ka lënë pas dëmtimin në gju dhe së fundmi edhe ka luajtur me Celsin në Premierë Ligë. Këtë herë do të mungojë Odise Roshi, ndërsa pjesa tjetër e futbollistëve janë konfirmuar nga trajneri brazilian i Kombëtares. Shqipëria do t'i nisë zyrtarisht përgatitjet të hënën, më 9 tetor, në "Shtëpinë e Futbollit". Lojtarët do të grumbullohen në kryeqytet, ndërkohë që është programuar që trajneri Sylvinho të dalë në konferencë për mediet ditën e shtunë prej orës 11:00 në sallën e konferencave në "Shtëpinë e Futbollit". Kombëtarja kuqezi do t'i luajë në "Air Albania" të dyja ndeshjet e tetorit. Fillimisht Shqipëria përballlet me Çekinë më 12 tetor, prej orës 20:45, ndërsa më pas në program është miqësorja me Bullgarinë më 17 tetor, në orën 18:00.



Keidi Bare, Qazim Laçi, Mirlind Daku, Sokol Cikaleshi, Armando Broja, Ernest Muçi, Myrto Uzuni, Jasir Asani, Taulant Seferi.

### Lista e futbollistëve

Etrit Berisha, Thomas Strakosha, Elhan Kastrati, Berat Gjimeshi, Ardian Ismajli, Arlind Ajeti, Ivan Balliu, Mario Mitaj, Elseid Hysaj, Enea Mihaj, Frederik Veseli, Ylber Ramadani, Klaus Gjasula, Kristijan Asllani, Nedim Bajrami, Arbnor Muja,

## Balotelli: PSG-së do t'i thosha po vetëm për 10 milionë euro në sezon

Adana, 6 tetor - Mario Balotelli është vendosur sërish në qendër të vëmendjes pas rikthimit të tij në Turqi me fanellën e Adana Demirsporit teksa së fundmi shënoi edhe dy gola ndaj Alanyasporit. Italiani në një intervistë për "TVPlay" zbulon disa detaje rreth së kaluarës duke theksuar se ka ëndërruar të luaj me Barcelonën fillimisht e më pas për Real Madridin. Ndër të tjera, sulmuesi shprehet se te PSG-ja do të transferohej vetëm nëse do të kishte një pagë prej 10 milionë eurosh, ndërsa edhe një herë tjetër thekson se është tifoz i Milanit. "Nëse nesër kam një ofertë nga PSG? Nuk do të luaja kurrë me PSG-në. Kam luajtur me Nicen dhe Marseillen në Francë dhe nuk më



pëlqen PSG. Por nëse më ofrojnë 10 milionë euro në sezon nuk do të refuzoja. Për 10 milionë euro do të luaja edhe me skuadrën e vëllait tim, Rovata (skuadër amatore në provincën e Brescias). Kur isha i ri ëndërroja të luaja me Barcelonën. Para se të shkoja tek Interi kalova

gjashtë muaj me katalanasit. Por, presidenti i Lumezzanos kërkoi shumë para për të më lënë të lirë, te Barcelona nuk mund të paguanin aq shumë për një lojtar që nuk ishte i akademisë së tyre. Pastaj duke u rritur dëshiroja më shumë Realin e Madridit. Shihja "Galaktikët", si mund të mos e ëndërroje atë skuadër?", ka thënë Balotelli. "Inter? U ndamë keq. Doja të rikthehesha, por një pjesë e tifozëve nuk më donte. Është e vështirë t'i thuash jo Interit. Vetëm një tifoz i Milanit do ta bënte. Kam pasur mundësinë edhe për të luajtur me Juventusin. Nëse do të zgjidhja sot mes Juventusit, Interit dhe Milanit, do të bëja një zgjedhje zemre dhe do të luaja me kuqezinjtë", u shpreh Balotelli.

## Lewandowski rrezikon të mos paraqitet në 'El Clasico'

Mjeku i Kombëtares së Polonisë, Jacek Jaroszewski, ka folur për situatën e lëndimit të Robert Lewandowskit. Në një intervistë për "TVP Sport", ai i ka alarmuar

tifozët blaugrana se mund të mos e shohin sulmuesin e tyre në fushë në "El Clasico" kundër Real Madridit të planifikuar më 28 tetor. "Unë fola me Robertin

dhe pashë rezultatet e testeve të tij. Fatkeqësisht lëndimi doli të ishte aq i rëndë sa të mos jetë i gatshëm për dy ndeshjet e radhës ndaj Ishujve Faroe dhe

Moldavisë. Ai ka lënduar njejtë ligamentit gjatë një kërcimi dhe besoj se klubi i Barcelonës ka vendosur një plan për rikuperimin e tij", ka thënë mjeku

i Polonisë. Në këtë mënyrë skuadra polake humbet një element kyç në dy ndeshjet e radhës ku luhen shpresat e fundit për kualifikimin në "Euro 2024".

### SHKURT

#### Kosova me dy boksierë në EUBC Cup

Federata e Boksit e Kosovës (FboxK) përmes një njoftimi ka bërë me dije se do të paraqitet me dy boksierë në "EUBC Cup" që po mbahet në Budva të Malit të Zi.

Boksierët Bashkim Bajoku (kategoria deri në 54 kilogramë) dhe Shpëtim Bajoku (kategoria deri në 67 kilogramë) do ta përfaqësojnë Kosovën në këtë garë. Ushtruesi i detyrës i selektorit, Musli Zymeri, ka paraqitur vetëm këta dy boksierë me përvojë për arsye të konkurrencës së fortë në këtë garë. Pjesëmarrës në "EUBC Cup" janë 178 boksierë nga 33 shtete, si kampionat olimpike, botëror e evropian, pasi që fondi i shpërblimeve i gjithë kësaj gare do të jetë rreth një milion euro.

#### Messi do të pensionohet në Newell's Old Boys

Lionel Mesi është kthyer në një bekim për Inter Miamin, madje edhe për vetë MLS, por "pleshti" nuk pritet të qëndrojë gjatë në ShBA jo vetëm për shkak të moshës. Mediet argjentinase zbulojnë se kampioni i botës ka vendosur që nga futbollit i luajtur do të tërhiqet me ekipin ku nisi gjithçka, Newell's Old Boys. Messi do të largohet nga ShBA-ja në vitin 2025 për t'u bashkuar me ekipin e tij të parë, në vendin e tij të lindjes. Kjo shihet edhe si një lëvizje për të qenë më në formë për Kampionatin Botëror që do të zhvillohet në 2026-n. Të njëjtën linjë pret ta ndjekë edhe miku i tij Neymar, i cili në vitin 2025 ka vendosur të kthehet te Santos për ta mbyllur futbollin.

#### Bayerni, gati ta rinovojë kontratën me Mullerin

Sulmuesi Thomas Muller ka kontratë me Bayern Munchenin deri në qershor 2024, por klubi gjerman e ka në plan t'i fillojë bisedimet për zgjatjen e kontratës me futbollistin veteran. Trajneri Thomas Tuchel beson shumë te roli i Mullerit brenda dhe jashtë fushës. 34-vjeçari është pjesë e Bayernit nga viti 2008, derisa ka zhvilluar 447 ndeshje dhe ka shënuar 144 gola.

#### Ancelotti: Të gjithë e duam Modriqin, por ai nuk është i lumtur

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka zbuluar se mesfushori Luka Modriq nuk është i kënaqur, ndërsa tha se ai e do shumë veteranin kroat. Minutat për Luka Modriqin janë të limituar në këtë edicion në klubin e Real Madridit ku deri më tash ka regjistruar vetëm 312 minuta. Këtë gjë e ka pranuar edhe trajneri Carlo Ancelotti, derisa konfirmoi se mesfushori kroat nuk është i lumtur. "Modriqi nuk është i lumtur dhe kjo duket qartazi, por unë bisedoj me të çdo ditë dhe ai ende është tejet i motivuar. Askush nuk është si ai në zhveshtore. Ai është lideri. Rëndësia e tij është maksimale. E dua tepër shumë. Të gjithë e duam atë", ka thënë Ancelotti.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1071 /1  
Dt: 06.10.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Udhëzimi Administrativ 05/2021 Vendimi (MASHTI) nr. 326/01B të dt. 28.07.2022 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## RI-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira dhe zëvendësim në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vend i lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për profilin e TIK-ut (20 orë mësimore);	Zëvendësim deri në kthim e mësimdhënës nga pushimi i lehonisë
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Dy (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit "Floktari", me nga 20 orë;	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) Instruktor /e për të profilit "Teknik i Optikës", 19 orë;	Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Për modulet e praktikës profesionale të profilit "Floktari", përparësi kanë kandidatët me përgatitje/ kualifikim Bachelor, niveli i V ose ekuivalent, me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në fushën përkatëse;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Neti" SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810324814 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Neti" D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810324814 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Neti" L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 810324814 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LOKALITETI KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

## FTESË PËR OFERTË-RISHPALLJE

Lloji i Kontratës:  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit 17-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-privatë, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

**Dosja për: Kontratë për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së**

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

### Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **18.10.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **20.10.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **20.10.2023 ora 14:00.**



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr.04/L-111 si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Uniteti" SH.A, në mbledhjen e mbajtur me 29.09.2023 vendosi të shpall këtë:

## KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës

**Pozita:** Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e dhe i/e Thesarit

**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve

**Vendi:** Mitrovicë

**Numri i Referencës:** 10-02-55

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

- Diplomë universitare fakulteti ekonomik ose ekonomist i diplomuar apo niveli master nga fusha e shkencave ekonomike, (financa publike dhe/ose kontabilitetit, menaxhim të biznesit, menaxhim dhe informatikë ose fusha të ngjajshme).
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në financa apo kontabilitet;
- Të jet i/e certifikuar në SCAAK, IKAF, ose shoqatat tjera profesionale (preferueshme).
- Njohuri të shkëlqyera të financave Publike
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhimin e financave
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj)
- Preferohet njohja e gjuhës Angleze
- Shkathtësi të larta organizative dhe aftësi për të punuar nën presion me kualitete të larta organizative.

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Do të menaxhojë nën drejtimin dhe përgjegjësinë e Kryeshefit Ekzekutiv, punët financiare të Kompanisë brenda kufizimeve të krijuara nga Bordi i Drejtorëve. Do të ketë autoritetin për të lidhë Kompaninë në kontrata në të gjitha transaksionet financiare dhe të jetë përgjegjës.
- Te mbajë llogaritë e Kompanisë të azhuruara dhe të sakta.
- Të krijojë dhe të udhëheqë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, përfshirë biletat, faturat e të hollave dhe mjeteve themelore fikse. Të monitoroj llogaritë e pagueshme dhe të koordinoj pagesat e faturave dhe biletave të posaçme. Të kontrollojë shpenzimet e punëtorëve për të siguruar përputhshmëri me politikën korporative dhe buxhetin e para pagesës.
- Të përgatisë shënimet e Kompanisë për auditimin e fundvitit.
- Të bëjë shqyrtimin, organizojë prokurimin dhe mbajtjen e të gjitha polisave të sigurimit afarist.
- Të koordinoj funksionet tjera të biznesit, si qiratë e ndërtesave, paisjeve dhe biletat me KSHE-ne dhe Zyrtarin e Prokurimit të Kompanisë.
- Të menaxhojë thesarin e Kompanisë
- Të caktoj dhe të përgatisë buxhetin.
- Për punën dhe detyrat e punës i përgjigjet KE-së së KRM "Uniteti" SH.A dhe Bordit të Drejtorëve.

**Procedura e aplikimit:**

- Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente;
- CV-ja (Biografia);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimi;
- Deklarata nën betim;
- Diplomën e fakultetit –kopje;
- Deshmitë e përvojës paraprake të punës.
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga Gjykata kompetente;

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Zyra e Arkivës. Konkursi zgjatë 30 ditë, dorëzimi i dokumentacionit fillon nga data **07.10.2023** dhe përfundon në ora 16:00 të datës **05.11.2023**. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacion përkatës, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit të Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](https://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ernis Rragomaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi".

- Arsim Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e Gjinnazit "Hajdar Dushi".

- Dr. Ukshin Ismaili, shpall të pavlefshme Licencën e Punës, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim me nr. KO-01754-01-01 datë: 29.09.1988.

- Armend Haxhikadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të patë dytë dhe të katërt të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari".

- Luljeta Peci, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEVCI".

- Alij Misini, shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës te mesme "ARKITEKT SINANI".

- Afrim Ferati, shpall te pavlefshme dëftesat e vitit te III,IV te shkollës se mesme te larte "Arkitekt Sinani", ish-shkolla Boris Kidriç.

- REGIONAL SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811999955.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





07.10.2023

Në bazë të nenit 17, paragrafi 3, pika 1 të Statutit të Kompanisë me Nr. 1/36 të dt. 20.04.2023, dhe në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, UD. Kryeshefi Ekzekutiv shpall:

### KONKURS

**Titulli i pozitës së punës:** Makinist

**Institucioni:** Hekurudhat e Kosovës-Trainkos-SHA.

**Tipi i Akt Emërimit të punës:** Orar të plotë pune

**Titulli i mbikëqyrësit:** Shef i Njësisë së Personelit të Trenave në TM

**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi

**Koeficienti/Kategoria:** K - V

**Procedura e aplikimit:** I jashtëm

**Vende të lira punë:** 3 pozitë (vend pune) Makinist

**Vendi:** Fushë Kosovë

**Qëllimi i vendit të punës:** Drejtimi i Trenit

#### Detvat dhe përgjegjësitë:

- Në pranim të detyrës vjen në gjendje të mirë fizike dhe shëndetësorë.
- Gjate ardhjes në punë kontrollon dhe nënshkruan librat e karakterit të përhershme dhe përkohshme
- Kontrollon ET 63 për riparimet e kërkuar dhe verifikon a janë mënjanuar.
- Pranon dhe verifikon gjendjen teknike të lokomotivës para nisjes për trenin e planifikuar
- Kontrollon dhe vërteton lokomotivën se a është e furnizuar me naftë, vaj, ujë, rërë dhe inventar;
- Pranimi e lokomotivës e bën përmes ET 76d.
- Ben manovrat e nevojshëm në kompleksin e M. Lokomotivave dhe T. Trenave.
- Është përgjegjës për manipulimin me lokomotivë prej pranimit deri në dorëzim të saj;
- Përcjell dhe zbaton rregullat e sigurisë në trafik dhe udhëzimet tjera që janë të
- Udhëheqë formularët e nevojshëm (Et-1 dhe fletudhëtimin);
- Kryen urdhëresat e drejtuesve të trenave sipas urdhërave të shkruar;
- Siguron lokomotivat gjatë sezonit dimëror nga ngricat;
- Kryen provën e frenimit nëpër stacione të trenat pa personel shoqëruar
- Dorëzimin e detyrës e bën në gjendje të mirë fizike dhe shëndetësorë, bën raport për punën përfunduar.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit;

#### Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Të këtë të kryer shkollën e mesme të lartë profesionale drejtimi tërheqje e trenave,
- Preferohet të ketë njohuri lidhur me programin e aftësimin profesional për makinist,
- Të jetë i sjellshëm dhe komunikativ,
- Të jetë i aftë të punoj nën presion
- Preferohet të ketë përvojë pune në këtë lëmi.
- Të dëshmon Certifikatën shëndetësorë për punë
- Preferohet të jenë nene moshën 40 vjeçare
- Kërkohe patën shoferi kategoria B.

Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e Tërheqjes se Trenave në HK-Trainkos-SHA apo në [www.trainkos.com](http://www.trainkos.com). Aplikacioni së bashku me dëshmitë të dorëzohen në ndërtesën e Tërheqjes se Trenave në HK-Trainkos-SHA, në adresën Sali Puçollli Pn, në Fushë Kosovë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarrë të mbyllur, në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: **25.10.2023 ora 16:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk iu kthehen. Vetëm kandidatet e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Data: 07.10.2023

Na osnovu člana 17. stav 3. tačka 1. Statuta Društva sa br. 1/36 OD data 20.04.2023, a Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03/L-212 kao i na osnovu člana 4 ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (MPMS) BR. 07/2017, O.G Glavnog Izvršnog Direktora objavljuje:

### KONKURS

**Naslov pozicije posla:** Mašinovoda

**Institucija:** Kosovske železnice-Trainkos – J.S.C

**Vrsta Imenovanje Posla:** Potpuno radno vreme

**Zvanje supervizora:** Šef Jedinice za vozno osoblje

**Trajanje ugovora:** 1 (jedna) godina, sa mogućnošću produženja

**Koeficijent/Kategorija:** K - V

**Procedura prijavlivanja:** Eksterni konkurs

**Vacanci:** 3 radno mesto (posao) Mašinovoda

**Grad:** Kosovo Polje

**Namena radnog mesta:** Mašinovoda

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Pri prijemu na dužnost dolazi u dobrom fizičkom i zdravstvenom stanju.
- Prilikom dolaska na posao proverava i potpisuje knjige trajnog i privremenog karaktera
- Proverava ET 63 za potrebne popravke i potvrđuje da su one izbegnute.
- Prihvata i verifikuje tehničko stanje lokomotive pre polaska na predviđeni voz
- Proverava i verifikuje da li je lokomotiva snabdevena dizelom, uljem, vodom, peskom i inventarom;
- Prijem lokomotiva se vrši preko ET 76d.
- Vršiti potrebne manevre u kompleksu M. lokomotiva i T. vozova.
- Odgovoran je za rukovanje lokomotivom od prijema do isporuke;
- Pridržava se i sprovodi pravila bezbednosti saobraćaja i druga uputstva
- Pripremiti potrebne formulare (Et-1 i putni list);
- izvršava naloge mašinovođa prema pismenim nalogima;
- Osigurava lokomotive tokom zimске sezone od mraza;
- Obavlja test kočenja na železničkim stanicama bez pratećeg osoblja
- Zadatak predaje u dobrom fizičkom i zdravstvenom stanju, sačinjava zapisnik o obavljenom poslu.
- Obavlja druge poslove na zahtev supervizora;

#### Uslovi i kriterijumi, kvalifikacija, radno iskustvo, veštine i druge veštine:

- Da završi vuču voza za vuču voza više stručne škole,
- Poželjno je imati znanja vezana za program stručnog osposobljavanja za mašinstvo,
- Budite ljubazni i komunikativni,
- Biti sposoban da radi pod pritiskom
- Poželjno je da imate radno iskustvo u ovoj oblasti.
- Potvrde o zdravstvenoj ispravnosti za rad
- Poželjno je da budu žene od 40 godina
- Potrebna je vozačka dozvola B kategorije.

Prijava i konkurs se mogu dobiti u zgradi KZ-Trainkos-J.S.C ili na [www.trainkos.com](http://www.trainkos.com). Zahtev zajedno sa dokazima treba dostaviti u zgradu za vuču vozova KZ-Trainkos-J.S.C. na adresi Sali Puçollli Bb, u Kosovu Polju. Dokumentaciju je potrebno dostaviti u zatvorenoj kovčeri, u kojoj mora biti upisano radno mesto za koje se prijavljuje. Poslednji rok za prijavu je: **25.10.2023 u 16:00** časova. Dokumentacija koja pristigne sa zakašnjenjem i nepotpuna smatraće se nevažećom. Dokumente je potrebno dostaviti samo u kopijama jer se isti neće vraćati. Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u užu izbor.

